



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 15/2015

Prishtinë, më 8.4.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Fatmir Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- ZRPK, Lejla Selimi-OSBE, Dardan Abazi – INDEP, Liridona Xhemajli- RTV-21, Besa Berisha dhe Arta Xhylani – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Listës së kandidateve për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të propozuar nga Qeveria;
3. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, propozoi që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, “Konkluzionet e Komisionit lidhur më Raportin Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2014”.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

2. Konkluzionet e Komisionit lidhur më Raportin Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2014

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, lidhur më shqyrtimin e Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2014, në mbledhjen e mbajtur më 7.04.2015, tha se në raport kanë dalë shumë informata që nuk reflektojnë në përmbajtjen e raportit të ZRRE-së, prandaj duhet të kërkojmë që të na sjellin edhe një raport shtesë më informata më të detajuara.

Visar Ymeri tha se pajtohet që duhet të kërkohej informatë shtesë nga ZRRE-ja, në lidhje me skenarët e ardhshëm që duhet t'i tregojë ZRRE-ja se cilat do të jenë kërkesat energjetike dhe projektet për të ardhmen.

Blerim Grainca tha se pajtohet që të kërkohej raport shtesë edhe për energjinë alternative, sepse Kosova ka obligime të ketë energji alternative prej 25% dhe është parakusht që duhet të investohet në këtë sektor të energjisë dhe po ashtu duhet të ketë ndryshim për tarifën dhe licencat.

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se pasi që Raporti i ZRRE-së ishte mjaft përmbajtësor në çështjet kyçe dhe ndonëse Raporti ndjek një metodologji të përcaktuar me ligj, ka shumë informata të cilat nuk e reflektojnë me përmbajtjen e tij, në çështjet akute dhe vështirësitë në zbatimin e ligjeve dhe me rregullimin e këtij sektori, andaj ZRRE-ja duhet të sjellë raport shtesë.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këto

Konkluzione

1. Raporti është përplot terminologji teknike dhe si i tillë, i cili është i vështirë për tu përdorur për njerëzit që nuk janë profesionist nga kjo fushë. Konkretisht tabela e fundit në të ardhurat e lejuara është e paqartë dhe kërkohej që ajo tabelë të zëvendësohet dhe të jetë sipas metodologjisë të miratuar nga Komisioni Hetimor.

2. Raporti të plotësohet me përshkrimin jo vetëm në emër të projekteve, por me prezantimin me vlera të investimeve të obliguara sipas operatorëve në KEK, KEDS dhe KOSST dhe të përshkruhet dinamika e tyre, dhe arsyet e përmbushjes dhe të mospërmbushjes. Raporti është i mangët në një sektor kyç që ka të bëjë me investimet, të cilat mund të kenë ndikim në cilësinë, në vëllimin dhe rregullsinë e furnizimit të konsumatorëve.

3. Në Raport duhet të përfshihet në mënyrë më të detajuar shthurja dhe konkretisht marrja e autorizimeve e aseteve dhe e obligimeve nga KEDS-i si dhe ndarja e tij prej KEK-ut. Konkretisht nuk ka qenë shumë e qartë çështja e 17 - 19 milionë eurove, çka do të ndodh, ku është ai proces sepse kjo mund ta pengoj konsumatorin. Deputetët dhe opinioni duhet ta dinë se ku gjinden dhe kjo duhet të përshkruhet në raport.

4. Duhet të jepet një pasqyrë më e detajuar e humbjeve komerciale dhe teknike. Humbjet komerciale dhe teknike tash për tash i mbulojnë konsumatorët që paguajnë rrymën. Shtrohet pyetja sa është kjo kushtetuese që konsumatori që është i rregullt me pagesën e energjisë

elektrike të mbuloj edhe për ata konsumatorë që KEK-u ose institucionet e Kosovës nuk janë në gjendje që të faturojnë ose të mbledhin faturat. Në qoftë se institucionet e Kosovës nuk mund të mbledhin energjinë në pjesë të caktuara të Kosovës, nuk është e drejtë që konsumatorët e rregullt të paguajnë atë, duhet t'i paguajnë institucionet ose dikush tjetër dhe kjo korporatë të mos të ngarkon çmimin e energjisë.

5. Gjithashtu duhet të përshkruhet se në çfarë faze jemi me ndërtimin e kapaciteteve e reja, pra në cilën fazë është ky proces. Dhe, lidhur me këtë, kërkojmë sqarim se çka mund të ndodhë lidhur me hendekun midis nevojës për furnizim dhe nevojës për ndërtim apo për rivatilizim, ngase nëse tash fillojmë me ndërtimin e “Kosovës së Re” dhe nëse aprovohet projekti, ai do të hyj në funksion dikur në vitin 2021 apo 2022, kur ndërkohe “Kosova A” sipas marrëveshjes me Komisionin Evropian dhe Bankën Botërore, duhet të mbyllet apo të të çmontohet deri në vitin 2017. Ndërkohe duhet të rivatilizohet “Kosova B” dhe mbase mund do të krijohet një hendek. Duhet të shikohet se çfarë do të ndodhë në këtë situatë, ngase bizneset dhe shoqëria kosovare mund të sillen në një situatë shumë problematike, prandaj kërkojmë sqarim nga ZRRE-ja se si e sheh këtë çështje në këtë situatë.

2. Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të propozuar nga Qeveria

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se Qeveria në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale e ka propozuar listën e kandidateve për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, dhe tani kjo listë e kandidatëve është sjelle në Kuvend. Ne si Komision Funkcional duhet të shqyrtojmë listën e kandidateve të propozuar nga Qeveria, ku janë propozuar 8 kandidatë, ndërsa Kuvendi duhet të zgjedhë 4 prej tyre. Ai i prezantoi kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët për t'u emëruar anëtarë të Bordit të KPMM-së, që rregullohen me paragrafin 6 dhe 7, të nenit 59, të Ligjit për Miniera dhe Minerale. Kryetari tha se këtu ka një zbrazëti ligjore sepse ligji nuk e përcakton se kush e emëron kryesuesin e Bordit dhe për këtë duhet të kemi një propozim, se a të emërohet ai që merr më shumë vota, apo atë ta emëroj vet Bordin.

Sala Berisha-Shala tha që është mirë që është propozuar nga Qeveria lista e kandidatëve për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, pasi që kemi mungesë të Bordit tash 6 muaj dhe tani është emergjente që të zgjidhet Bordin i KPMM-së, kur dihet se në bazë të Ligjit për Miniera dhe Mineral, ky Bord ka kompetenca vendimmarrëse, sidomos për licenca. Ajo theksoi se në bazë propozimeve dhe CV-ve që po i shohë, të gjithë kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore dhe profesionale, andaj, edhe përbërja do të jetë shumë profesionale dhe kërkoj që sa më shpejt të procedohen për Kuvend në mbledhje plenare lista e kandidatëve, në mënyrë që Bordin i KPMM-së jetë funksional.

Visar Ymeri tha që në bazë të CV-ve, jo gjithë kandidatët propozuar nga Qeveria për Bordin KPMM-së i plotësojnë kushtet që parashihen në Ligjin për Miniera dhe Minerale, në nenin 59, kushtet e paragrafit 6.5 dhe 6.6, ku i kanë “Certifikatat nga Gjykata që s'janë nën hetime”, por nëse nuk kanë “Vërtetim të Gjykatës se a kanë qenë të dënuar apo jo për ndonjë vepër penale” ashtu siç shkruan në ligj. Atëherë nuk mund të vërtetojmë që i plotësojnë kushtet ligjore në bazë të ligjit. Propozoj që të kërkohet nga Qeveria, që t'i sjellin vërtetimet për kandidatët të cilët nuk janë të dënuar nga gjykata. Po ashtu në ligj kërkohet që mos të jenë të ndikuar politikisht apo edhe të mos të jenë të dënuar nga ndonjë gjykatë administrative apo të shkarkuar nga ndonjë punëdhënës, ndërsa as për këto nuk kemi të dhëna nga CV-të e kandidatëve, pra duhet të kërkohet nga një letër referencë për çdo kandidatë nga punëdhënësi. Propozoj që të kërkohet nga Qeveria që të plotësohen CV-të e kandidatëve më këto të dhëna, tha Ymeri.

Propozimi i deputetit Visar Ymeri u përkrah nga Komisioni.

Raif Qela lidhur më kushtet që kërkohen për Bordin KPMM-së, në nenin 59 të paragrafit 6.6, tha që nuk është e përcaktuar mirë që duhet të bëhet ndonjë verifikim për kandidatët e Bordit të KPMM-së.

Enver Hoti tha që kjo mund të verifikohet shumë lehtë nga punëdhënësi dhe duhet t'i kemi këto informata.

Muhamet Mustafa, kryetar, theksoi së bazë të CV-ve, kandidatët janë mjaftë kualitativ dhe kanë përgatitje adekuate profesionale në këtë fushë, në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale, prandaj, mund të zgjedhim një Bord shumë profesional. Ai i njoftoi anëtarët e Komisionit me shkresën që ka marrë nga një kandidate, znj. Rrezarta Pushkolli- Makolli, e cila i ka paraqitur disa vërejtje lidhur më vendimin e Qeverisë, por tha se nëse Komisioni nuk ka kompetencë të merremi më këtë çështje, prandaj pala duhet të udhëzohet që të ankohej në Qeveri.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të emërohen 4 (katër) nga 8 (tetë) të propozuarit e Qeverisë, për anëtarë të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, si vijon:

- 1.1. Musa Shabani*
- 1.2. Festim Kutllovci*
- 1.3. Selim Frangu*
- 1.4. Avdi Konjuhi*
- 1.5. Kemajl Zeqiri*
- 1.6. Shpend Terdeva*
- 1.7. Bekim Troni*
- 1.8. Azem Rexhaj*

2. Kandidati i cili merr më së shumti vota nga deputetët, të emërohet si Kryesues i Bordit për Komisionin të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ose atë ta zgjedh vetë Bordi në seancën parë.

3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

4. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa